



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-24-8039-5-1-1/C992
14 Nr. 1062/24
Dt. 09.12.2024

KONTRATË PUNE

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **z. Ilmi Azemi, Drejtor i Prokurimit** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. **N.N.P. Wenda, F.SH. DOLAK**, emri i biznesit, me seli në Vushtrri, me ARBK : 600203939, të cilën e përfaqëson **z. Kadri Selmani** në tekstin e mëtejshëm: **PUNEKRYESI**,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara me poshtë: Lot 2 Ndërtimi – Rikonstruimi i fushave sportive Samadrexhë, Maxhunaj, Pestovë, Stanocë i Ultë, Pantinë, Shtitaricë dhe Novolan (Projekt 3 vjecare) me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	80	3	9	5	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	6	7	5	2	1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Lot 2 Ndërtimi – Rikonstruimi i fushave sportive Samadrexhë, Maxhunaj, Pestovë, Stanocë i Ultë, Pantinë, Shtitaricë dhe Novolan (Projekt 3 vjecare), në pajtim me Specifikat Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: jo më gjatë se 36 muaj pas datës së nënshkrimit të kontratës.

1.3 Vendi i punimve do të jetë : fusha sportive Samadrexhë, Maxhunaj, Pestovë, Stanocë i Ultë, Pantinë, Shtitaricë dhe Novolan (Projekt 3 vjecare), në pajtim me Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate.

1.4 Incotermit i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

2.2 Çmimi total i kontratës do të jetë: 412,292.52 €; [katërqindedymbëdhjetëmijëdyqindenëntëdhjetëdy/52].

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.5 Kontraktuesi do të depozitoi Sigurimin e Ekzekutimit në kohëzgjatje prej 36 muaj nga data e saktësuar për nënshkrimin e Kontratës. Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është : 10 % (Dhjetë përqindë) nga vlera e përgjithshme e kontratës. Dokumenti – Polisë e sigurimit apo dokument bankar i lëshuar nga ndonjë Bankë apo kompani e sigurimeve të licensuar nga Baka Qendrore e Kosovës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do

të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqipe**² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Kadri Selmani
Pozita:	Drejtor	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09.12.2024	Data:	09.12.2024
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.